



REPUBLIKA E KOSOVES • REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Nr. i Org. Org. jedinica Org. Unit	SP-02	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	3589-2/24
Nr. i Fajevë Br. Stranica No. Pages	-04-	Data Datum Date	23.09.24
PRISHTINË / A			No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	26.03.2024
REFERENC-Ë:	23/6103/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"ÇEKU TRADE" Sh.p.k. Gorazhdevc, Pejë Seperim i rërës dhe zhavorit
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për Leje Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore për vazhdim të operatorit "ÇEKU TRADE" Sh.p.k. Gorazhdevc, Pejë, me Nr. Prot. 23/6103/MMPHI.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, një sërë takimesh dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

- Vendimi për Leje Mjedisore për operatorin "ÇEKU TRADE" Sh.p.k. Gorazhdevc, Pejë për veprimtarinë: Seperim i rërës dhe zhavorrit, Gorazhdevc

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/3589/MMPHI
Datë: 03.09.2024.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:



V E N D I M

1. Operatorit "ÇEKU TRADE" Sh.p.k. Gorazhdevc, Pejë, i refuzohet kërkesa për tu pajisur me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Seperim i rërës dhe zhavorrit, Gorazhdevc, me Nr.Prot. 24/3589/MMPHI, në ngastrën nr.P-71611020-00049-1, zona kadastarle, Gorazhdevc , Pejë.

A r s y e t i m

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kriterëve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.16/2042/1-ZSP/194/16, me datë: 12.10.2016 ;
- Licencë shfrytëzimi nga KPMM me Nr.876/KPMM/2022 të dt.11.10.2022 me validitet 21.08.2024;
- Leje Ujore për shfrytëzim, nr.1523-ZSP-2021, lëshuar me datë: 30.12.2021;
- Leje Ujore për shkarkim, nr. 1522-ZSP-2021, lëshuar me datë: 30.12.2021.

Operatori nuk ka plotësuar kushtet si më poshtë :

- Operatori nuk ka plotësuar kushtet e Pëlqimit Mjedisor për ndërtimin e baseneve sedimentuese nga procesi i shpërlarjes së rërës dhe zhavorrit;
- Shfrytëzimi i ujit, bëhet nga një gropë e hapur i ujit nëntokësor, i pa kaptazhuar sipas standarteve të caktuara;
- Nuk ka mirëmbajtur hapësirën ku operon, duke depozituar lymen në grumbuj në sipërfaqe të tokës, pa e monitoruar dhe përcaktuar vend deponimit;

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, vlerëson se operatori, nuk plotëson kushtet teknike dhe mjedisore dhe merr Vendim për Refuzim e kërkesës për tu pajisur me Leje Mjedisore.

Kjo Leje Mjedisore Refuzohet, në përputhje me nenin 11 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së



Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës-Shtime;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së